



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. 406 prot.

Kamëz, më 17 . 5 .2024

VENDIM

Nr. 406 , datë 17 . 5 2024

PËR

MIRATIMIN E NDËRMARRJES SË NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS "SULEJMAN ELEZI" NË ZONËN LAKNAS, NË NJËSINË STRUKTURORE KZ_UB_AS3-1_1, BASHKIA KAMËZ.

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Vendimi Nr.294, datë 15.05.2024 të Këshillit të Ministrave "Për Shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim në Fshatin Laknas" Bashkia Kamëz, dhe caktimin e Fondit Shiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", nenin 13, pika 1, shkronja "b" të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", nenin 72 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar), Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, miratuar me Vendimin Nr.1, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit, Vendimi i Komisionit Shtetëror i Rindërtimit Nr.17, datë 11.05.2020.

V E N D O S A :

1. Miratimin e nismës për hartimin e Planit të Detyruar Vendor në funksion të procesit të ndërtimit për shkollën "Sulejman Elezi", në zonën Laknas, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi .
2. Referuar shkresës dhe degjesës publike ardhur nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës .
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit sipas afateve të përcaktuara ligjore.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETAR

Rakip SULLI

